

VENDIM
Nr.37, datë 27.04.2010

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “400 KV” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, germa “a, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pikat 1 germa “g”, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.04.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “400 kv” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “400 kv” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Autoriteti i Konkurrencës, me vendimin nr. 144, datë 23.03.2010, ka vendosur t’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë ta pajisë me licencë për tregtimin e energjisë elektrike shoqërinë “400 KV” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “400 KV” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5- vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I ERE-S
Bujar NEPRAVISHTA